



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Ballsh, më 12.06.2023

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant dhe rërë bituminoze, për mirëmbajtje rrugësh”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

44113900-4

Vlera e fondit limit:

20,831,158 (njëzetëmilion e tetëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) **Lekë pa TVSH**

Bazuar në nenin 53, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 67, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga Bashkia Mallakastër, në rolin e Organit Qendror Blerës (OQB), për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër, ndërsa nënshkrimi i kontratës do të bëhet nga vetë AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri përkatës i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesë blerjes (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor (OQB) Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesit duhet të paraqesin:

- a.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c.** Formularin e Ofertës dhe Listën e Çmimeve, sipas shtojcave 1 dhe 2.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar Ofertuesit duhet të paraqesin:

2.1. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivit të bilanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku Operatorët Ekonomikë ushtrojnë dhe kanë ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

3. Kapaciteti teknik:

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik ofertues duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

b. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35% të vlerës së fondit limit.*

Në përcaktimin e vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, është mbajtur në konsideratë fakti që vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, është mbi kufirin e ulët monetar dhe nën kufirin lartë monetar.

Vlera e kërkuar për furnizimet e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave minimalisht:

- 6 (gjashtë) shoferë për kamiona (me leje drejtimi kategoria C minimale), për të cilët duhet të paraqiten kontratat përkatëse të punës (të vlefshme), lejet e drejtimit (të vlefshme)

lëshuar nga DPSHTRR, si dhe listë-pagesat e punonjësve të shoqërisë sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Në rastin kur mjetet janë marrë me qira, nuk është kusht që shoferët të jenë në listëpagesat e shoqërisë. Në këtë rast, kushti është që në kontratën e qiramarrjes së mjetit të jetë qartësisht e përcaktuar se shërbimi i drejtimit të mjetit (përfshirë gjeneralitetet e shoferit dhe leja e drejtimit kategoria C minimale) është i përfshirë në qiramarrje.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 5, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë punonjësit e nevojshëm për të zbatuar kontratën. Punonjësit e kërkuar lidhen drejtpërdrejt me volumet dhe natyrën e kontratës, dhe garanton Autoritetin Kontraktor për ekzekutimin me sukses të proceseve të nevojshme për lëvrimin e mallrave, e konkretisht procesit të transportimit dhe shkarkimit të mallrave në vend depozitimitin e përcaktuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Gjithashtu, kjo kërkesë është në përputhje edhe numrin e mjeteve të transportit, si dhe me sasinë e mallrave të kërkuara dhe për të garantuar AK për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi brenda afatit 3 mujor të përcaktuar.*

3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi noteriale, të paktën 1 (një) karrierë guri gëlqeror. Për këtë duhet të paraqitet:

- Në rastin kur karriera është në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni i pronësisë, shoqëruar me Leje Shfrytëzimi Minerare të gurit gëlqeror lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe me Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Karrierë guri gëlqeror”, të lëshuar nga QKL.
- Në rastin kur karriera është marrë me qira, duhet të paraqitet kontratë noteriale qiraje (e vlefshme), shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë së qiradhënësit, shoqëruar gjithashtu me Leje Shfrytëzimi Minerare të gurit gëlqeror lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe me Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Karrierë guri gëlqeror”, të lëshuar nga QKL.
- Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale me prodhues ose subjekte të autorizuara nga prodhuesi, duhet të paraqitet kontrata noteriale e furnizimit (e vlefshme) dhe nëse kjo kontratë është lidhur me subjekte të autorizuara nga prodhuesi, atëherë duhet njëkohësisht të vërtetohet edhe lidhja e këtij të fundit me prodhuesin (adresë, nr.kontakti etj) me qëllim verifikimi.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Nëpërmjet këtij kriteri OE ofertues duhet të dëshmojnë se kanë dokumentacion të rregullt tekniko-ligjor dhe/ose zotërojnë kontratat përkatëse që lidhen me lëvrimin e mallrave të kërkuara nga AK, në funksion të zbatimit korrekt të kontratës dhe legjislacionit në fuqi.

Kjo kërkesë shërben si garanci për AK për ekzekutimin e kontratës, lidhur me operimin dhe rakordimin me shpejtësi me kontraktuesin, i cili, në rast nevojash emergjente për mallrat objekt kontrate (çakull dhe stabilizant) duhet të jetë disponibël, sa i përket lëvrimin të këtyre mallrave. Disponimi i karrierës në njërën prej formave të kërkuara, garanton autoritetin kontraktor për realizimin e kontratës me efikasitet, referuar këtu kërkesave momentale që mund të paraqiten nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, e cila do të merret me shpërndarjen e këtyre mallrave në objektet e përcaktuara nga ajo. Dokumentacioni i kërkuar në këtë kërkesë, është konform parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi dhe krijon bindjen për AK, për një veprimtari me baza dhe instalacione korrekte dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, sa i përket shfrytëzimit, përpunimit dhe tregëtimit të mallrave objekt kontrate. Gjithashtu kjo kërkesë është në harmoni edhe me afatin e lëvrimin, afat i cili është parashikuar të jetë tre muaj nga data e lidhjes së kontratës.

3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi noteriale, të paktën 1 (një) pikë/impianit për nxjerrje dhe përpunim të rërës bituminoze. Për këtë duhet të paraqitet:

- Kur është në pronësi: Të paraqitet dokumentacioni i pronësisë së pikës/impianit, shoqëruar me Leje Shfrytëzimi Minerare të rërës bituminoze (aktive) lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe me Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me qiell të hapur dhe nga gurore”, të lëshuar nga QKL.
- Kur është marrë me qira: Të paraqitet kontrata noteriale e qirasë (e vlefshme), shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë së qiradhënësit, shoqëruar gjithashtu me Leje Shfrytëzimi Minerare të rërës bituminoze (aktive) lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar, si dhe me Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B për “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me qiell të hapur dhe nga gurore”, të lëshuar nga QKL.
- Në rast se Operatori Ekonomik ofertues ka kontratë furnizimi noteriale me prodhues ose subjekte të autorizuar nga prodhuesi, duhet të paraqitet kontrata noteriale e furnizimit (e vlefshme) dhe nëse kjo kontratë është lidhur me subjekte të autorizuar nga prodhuesi, atëherë duhet njëkohësisht të vërtetohet edhe lidhja e këtij të fundit me prodhuesin (adresë, nr.kontakti etj) me qëllim verifikimi.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Nëpërmjet këtij kriteri OE ofertues duhet të dëshmojnë se kanë dokumentacion të rregullt tekniko-ligjor dhe/ose zotërojnë kontratat përkatëse që lidhen me lëvrimin e mallrave të kërkuara nga AK, në funksion të zbatimit korrekt të kontratës dhe legjislacionit në fuqi.

Kjo kërkesë shërben si garanci për AK për ekzekutimin e kontratës, lidhur me operimin dhe rakordimin me shpejtësi me kontraktuesin, i cili, në rast nevojash emergjente për mallrat objekt kontrate (rërë bituminoze) duhet të jetë disponibël, sa i përket lëvrimin të këtyre mallrave. Disponimi i karrierës në një rën prej formave të kërkuara, garanton autoritetin kontraktor për realizimin e kontratës me efikasitet, referuar këtu kërkesave momentale që mund të paraqiten nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, e cila do të merret me shpërndarjen e këtyre mallrave në objektet e përcaktuara nga ajo. Dokumentacioni i kërkuar në këtë kërkesë, është konform parashikimeve të bëra në legjislacionin në fuqi dhe krijon bindjen për AK, për një veprimtari me baza dhe instalacione korrekte dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, sa i përket shfrytëzimit, përpunimit dhe tregëtimit të mallrave objekt kontrate. Gjithashtu kjo kërkesë është në harmoni edhe me afatin e lëvrimin, afat i cili është parashikuar të jetë tre muaj nga data e lidhjes së kontratës.

3.5. Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira:

- minimalisht 6 (gjashtë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet: -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik (e vlefshme); -polica e sigurimit të detyrueshëm (e vlefshme); - certifikata e transportit të mallrave (e vlefshme), lëshuar nga organet kompetente. Ndërsa në rastin kur janë marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë, e vlefshme.

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, nëpërmjet të cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të paraqitura dhe se këto mjete nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, por do të jenë në dispozicion të lëvrimin të mallrave objekt prokurimi.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë mjetet e deklaruara si më sipër, në çdo kohë, nga momenti i paraqitjes së ofertës deri në përfundimin e kontratës.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 5, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht (në pronësi ose të

siguruara me qira) mjetet e nevojshme për lëvrimin e mallrave të kërkuara nga AK, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Numri dhe lloji i mjeteve (në pronësi ose të siguruara me qira), janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar orëve të punës, dhe afatit të lëvrimit të mallrave objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket mjeteve të kërkuara, gjë për të cilën janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten. Mjetet “6 kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton” të kërkuar, janë në përputhje me natyrën, volumin dhe afatin e lëvrimit prej 3 muaj dhe lidhen ngushtësisht me procesin e transportimit të mallrave të kërkuar, me destinacion vendgrumbullimet e përcaktuara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Konkretisht, referuar sasisë totale të mallrave të kërkuara, e cila është konvertuar nga njësia matëse m³, në ~ 14.250 ton dhe afatit të lëvrimit parashikuar 3 muaj (66 ditë pune - duke mbajtur parasysh edhe ditet e pushimit), është parashikuar që secili prej kamionave 18 tonësh të realizojë 2 rrugë vajtje-ardhje në ditë. Pra duke marrë për bazë dhe duke kalkuluar kapacitetin mbajtës të kamionave, afatin e lëvrimit dhe parashikimin normal të transportimit të mallrave prej 2 rrugë vajtje-ardhje në ditë, përmbushen kushtet për të realizuar në kohë lëvrimin e mallrave të kërkuara. Mjetet e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorëve ekonomikë për përmbushjen me sukses të kontratës.

3.6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akredimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen janë si më poshtë dhe duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente,
 - Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 ose ekuivalente,
- Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve / furnizimeve / shërbimeve që marrin përsipër të realizojnë sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vet natyrën e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit, janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë në standardet e tregut. Në këtë kuptim gjykohet se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë edhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim është eficient duke mundësuar dhe ofruar një cilësi më të mirë dhe me çmime konkurruese.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik lidhur me menaxhimin e rreziqeve mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem aplikohet gjerësisht për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Në këtë kuptim gjykohet se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit që kryen si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim është eficient dhe mundëson ushtrimin e veprimtarisë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. Pra, nisur edhe nga vetë përcaktimi ligjor, kërkesat e përcaktuara sipas kësaj pike, janë në përputhje dhe harmoni me natyrën dhe përmasat e objektivit që prokurohet.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përgatitur nga strukturat përkatëse të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (NSHP) dhe janë përcjellë pranë Bashkisë Mallakastër me shkresë zyrtare, për të filluar procedurat e prokurimit. Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e NSHP. Specifikimet teknike për mallrat e kërkuara, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden në shtojcën përkatëse të setit të DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Fondi limit: 20,831,158 Lekë pa TVSH

Përllogaritja e fondit limit është realizuar në bazë të VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Afati i Lëvrimet: 3 (tre) Muaj nga data e lidhjes së kontratës

.....
.....
.....

NJËSIA E PROKURIMIT